



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Tiranë, më 26.04.2017

### NJOFTIM

#### “PËR NGRITJEN NË DETYRË NË KLSH”

Në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjin nr. 152/2013, datë 01.10.2013 “Për Nëpunësin Civil”, si dhe Vendimin nr. 4, datë 03.02.2016 të Kryetarit të KLSH “Për Strukturën e Renditjes së Punëve, Klasifikimin e Vendeve të Punës dhe Nivelin e Pagave në Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar;

#### **Ju njoftojmë se:**

Kanë filluar procedurat për ngritje në detyrë përkatësisht për:

#### **I. Për pozicionin e Audituesit të Lartë në Departament Auditimi.**

Në konkurrim ftohen të marrin pjesë Audituesit e I (parë) që plotësojnë këto kriteret:

- të kenë eksperiencë pune në KLSH
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë rezultate pozitive në auditime;
- të kenë dhënë kontribut në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista (përkthime) të ndryshme etj;
- të zotërojnë gjuhën angleze;

#### **IV. Për pozicionin e Audituesit të I(parë) në Departament Auditimi.**

**II.** Në konkurrim ftohen të marrin pjesë Audituesit e II (të dytë) që plotësojnë këto kriteret:

- të kenë eksperiencë pune në KLSH
- të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- të kenë rezultate pozitive në auditime;
- të kenë dhënë kontribut në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista (përkthime) të ndryshme etj.
- të zotërojnë gjuhën angleze

Të gjithë të interesuarit duket të paraqesin kërkesën e tyre pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore deri më datë 26 Maj 2017.

Testimi për ngritje në detyrë do të zhvillohet bazuar në rezultatet e punës audituese, nga vlerësimi i dosjeve individuale, provim një Manual, punimi dhe mbrojtja e një teme të veçantë si dhe intervista e strukturuar me gojë nga Komiteti i Pranimet Për Ngritjen në Detyrë.

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**